




Datë: 15.04.2024

DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM

Mbështetur në nenin 62 pika 62.3 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, qershor 2088), nenit 47 pika c). Të Statutit të Komunës së Fushë Kosovës nr.98 datë: 30.07.2012, nenit 2, 3 i Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë Kosovës nr.83 e datës 14.06.2013, dhe në mbështetje të vendimit me numër 465 të datës 12.04.2024 aprovuar nga Kryetari i Komunës, drejtori i Drejtorisë për Arsim me datë 12.04.2024 shpall:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Për ndarjen e ndihmës momentale

Komuna e Fushë Kosovës ndan ndihmë momentale për këto kategori:

1. Studentet bachelor, master (përparësi kanë studentet në fakultetet shtetërore me degë deficitare: teknik, shkenca natyrore matematikore, mjekësi, arkitekturë, inxhinieri të cilët përfitojnë edhe nën notën mesatare 7.5);
 2. Studentët për studime jashtë vendit;
 3. Trajnerët dhe mësimdhënësit me projekte për ngritje të cilësisë për kurrikulë dhe trajnime tjera të ngjashme;
 4. Nxënësit me nevoja të veçanta;
 5. Fëmijët/nxënësit me inteligjencë superiore;
 6. Financimi i transportit të nxënësve në shkollën speciale për të verbër në Pejë.
- Të drejtë aplikimi kanë vetëm studentët, nxënësit, fëmijët, mësimdhënësit që janë banorë të Komunës së Fushë Kosovës pa kurrfarë dallime etnike, gjinore, fetare dhe politike.

• Kriteret për studentët bachelor, master dhe jashtë vendi:

1. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës (dëshmi letërnjoftimi ose certifikata e tatimit në pronë, së paku tri vitet e fundit);
2. Të ketë të regjistruar vitin akademik 2023/24;
3. Nota mesatare e studimeve 7.5 e më lart;
4. Për studentet që vijnë për studime jashtë vendit, dëshmitë nga universiteti që është duke studiuar.

Dokumentet e domosdoshme për aplikim për studentët bachelor, master dhe jashtë vendi:

1. Aplikacioni sipas formës së komunës (e gjeni të publikuar bashkë me thirrjen publike ose në zyrën pritëse në Komunën e Fushë Kosovës);
 2. Kopja e letërnjoftimit;
 3. Kopja e ID-së së studentit;
 4. Vërtetimi se studenti ka të regjistruar vitin akademik 2023/24 (origjinale);
 5. Certifikata e notave (origjinale);
 6. Deklarata e bashkësisë familjare (për studentet që janë dy e më tepër nga një familje);
 7. Vërtetimin/konfirmimin e llogarisë bankare (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- *Për studentet me nevoja të veçanta i bashkëngjitet edhe Vendimi/Vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që dëshmon nevojën e veçantë.

- **Kriteret për nxënësit me nevoja të veçanta:**

1. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës (dëshmi letërnjoftimi ose certifikata e tatimit në pronë, së paku tri vitet e fundit);
2. Vërtetimi nga shkolla që është nxënës i Komunës së Fushë Kosovës;
3. Vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Dokumentet e domosdoshme për aplikim për nxënësit me nevoja të veçanta:

1. Aplikacioni sipas formës së komunës (e gjeni te publikuar bashkë me thirrjen publike ose në zyrën pritëse në Komunën e Fushë Kosovës);
2. Kopja e letërnjoftimit të prindit;
3. Ekstrakti i lindjes së fëmijut;
4. Vërtetimi nga shkolla që dëshmon se është nxënës në institucionet arsimore në Komunën e Fushë Kosovës;
5. Vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
6. Vërtetimin/konfirmimin e llogarisë bankare të prindit (nuk pranohet kopje e kartelës bankare).

- **Kriteret për fëmijët/nxënësit me inteligjencë superiore të cilët përfaqësojnë Komunën e Fushë Kosovës në gara ndërkombëtare:**

1. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës (dëshmi letërnjoftimi ose certifikata e tatimit në pronë, së paku tri vitet e fundit);
2. Dëshmitë sipas UA nr.14/2019 nga MASHT;
3. Ftesa zyrtare nga organizatori i garës.

*Sqarim: shpenzimet mbulohen vetëm për nxënësin/fëmijun që merr pjesë në gara.

- **Dokumentet e domosdoshme për aplikim për fëmijët/nxënësit me inteligjencë superiore të cilët përfaqësojnë Komunën e Fushë Kosovës në gara ndërkombëtare:**

1. Aplikacioni sipas formës së komunës (e gjeni te publikuar bashkë me thirrjen publike ose në zyrën pritëse në Komunën e Fushë Kosovës);
2. Kopja e letërnjoftimit të prindit;
3. Ekstrakti i lindjes së fëmijut;
4. Vërtetimi nga shkolla që dëshmon se është nxënës në institucionet arsimore në Komunën e Fushë Kosovës;
5. Dëshmitë sipas UA nr.14/2019 nga MASHT;
6. Ftesa zyrtare për nxënësin/fëmijun nga organizatori i garës (të bashkëngjitet agjenda, pasqyra e shpenzimeve dhe dokumente tjera shtesë);
7. Vërtetimin/konfirmimin e llogarisë bankare të prindit (nuk pranohet kopje e kartelës bankare).

- **Kriteret për financimin e transportit të nxënësve në shkollën speciale për të verbër në Pejë:**

1. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës (dëshmi letërnjoftimi ose certifikata e tatimit në pronë, së paku tri vitet e fundit);
2. Vërtetimin që dëshmon se është nxënës i shkollës speciale për të verbër në Pejë;
3. Vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që dëshmon aftësinë e kufizuar.

Dokumentet e domosdoshme për aplikim për financimin e transportit të nxënësve në shkollën speciale për të verbër në Pejë:

1. Aplikacioni sipas formës së komunës (e gjeni te publikuar bashkë me thirrjen publike ose në zyrën pritëse në Komunën e Fushë Kosovës);
2. Letërnjoftimi i prindit;
3. Ekstrakti i lindjes së fëmijut;
4. Vërtetimin që dëshmon se është nxënës i shkollës speciale për të verbër në Pejë;
5. Vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
6. Vërtetimin/konfirmimin e llogarisë bankare të prindit (nuk pranohet kopje e kartelës bankare).

• **Kriteret mësimdhënës për projekte për ngritjen e cilësisë të cilët janë të akredituar në programet e ndryshme nga MASHT-i:**

1. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës (dëshmi letërnjoftimi ose certifikata e tatimit në pronë, së paku tri vitet e fundit);
2. Të jetë i licencuar nga MASHT-i si trajner për ofrimin e trajnimeve të kurrikulës, edukim në karrierë, mësim me zgjedhje dhe trajnimeve të ngjashme të cilët ndikojnë në ngritjen e cilësisë në arsim.

Dokumentet e domosdoshme për aplikim mësimdhënës për projekte për ngritjen e cilësisë të cilët janë të akredituar në programet e ndryshme nga MASHT-i:

1. Letërnjoftimi i aplikuesit;
2. Certifikata/Licenca nga MASHT-i;
3. Formulari i projekt propozimit;
4. Formulari i projekt-buxhetit;
5. Vërtetimin/konfirmimin e llogarisë bankare (nuk pranohet kopje e kartelës bankare).

• **Kriteret për botime letrare të nxënësve dhe mësimdhënësve të institucioneve arsimore në Komunën e Fushë Kosovës**

1. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës (dëshmi letërnjoftimi ose certifikata e tatimit në pronë, së paku tri vitet e fundit);
2. Të jetë nxënës/mësimdhënës i institucioneve arsimore në Komunën e Fushë Kosovës.

Dokumentet e domosdoshme për aplikim për botime letrare të nxënësve dhe mësimdhënësve të institucioneve arsimore në Komunën e Fushë Kosovës:

1. Letërnjoftimi i aplikuesit;
2. Formulari i projektit (e gjeni të bashkangjitur së bashku me thirrjen publike);
3. Vërtetimin/konfirmimin e llogarisë bankare (nuk pranohet kopje e kartelës bankare).

Vërejtje: Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen nga ana e komisionit.

Thirrja mbetet e hapur 15 dite pune nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve në faqen zyrtare të Komunës së Fushë Kosovës.

Drejtore i DKA- së
Fatlun Berisha

